

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË KATARIT, PËR TRANSPORTIN DETAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Kjo marrëveshje ka për qëllim forcimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve në lundrimin tregtar dhe çështje të transportit detar të cilat do të kontribuojnë në zhvillimin e marrëdhënieve të përbashkëta ekonomike dhe tregtare ndërmjet të dyja vendeve.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji nuk është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim e miratim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2019.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Kjo marrëveshje do të shërbejë për forcimin e marrëdhënieve ndërmjet të dyja vendeve në fushën e transportit detar, në bazë të parimeve të lundrimit të lirë, duke marrë parasysh parimet e barazisë, të bashkëpunimit dhe të përfitimeve të ndërsjella.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në mbështetje të Kushtetutës dhe në harmoni të plotë me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Marrëveshja është miratuar, në parim, me vendimin nr.316, datë 15.4.2015, të Këshillit të Ministrave.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE TË BE-SË

Ky projektligj nuk synon dhe nuk përafroon ndonjë akt të veçantë të *acquis* të BE-së dhe, si rrjedhojë, nuk shoqërohet nga tabelat e përputhshmërisë.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Kjo marrëveshje bazohet në konventën e Kombeve të Bashkuara për ligjin e detit si dhe në konventa të tjera ndërkombëtare, për sigurinë e transportit detar, lehtësimin e transportit detar ndërkombëtar, kushtet e jetës dhe të punës së detarëve, transportin e mallrave të rrezikshme dhe mbrojtjen e mjedisit detar. Kjo marrëveshje përmban 16 nene, si më poshtë vijon:

Në nenin 1 jepen përkufizimet e termave sipas konventave ndërkombëtare në fushën e detarisë.

Neni 2, liria e trafikut dhe mosdiskriminimi, i inkurajon shtetet palë të marrëveshjes për të kryer transport ndërkombëtar detar ndërmjet të dyja vendeve, duke respektuar të drejtën ndërkombëtare si edhe kuadrin ligjor kombëtar të secilit shtet. Në zbatim të shkronjës “a”, të pikës 3, të nenit 22, të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Administrata detare mund të lejojë lundrimin e anijeve që mbajnë flamurin e një shteti ndërmjet porteve shqiptare, në bazë të parimit të barazisë që ka Republika e Shqipërisë me atë shtet.

Në nenin 3, trajtimi i barabartë i mjeteve lundruese, parashikohet trajtimi në mënyrë të barabartë i mjeteve lundruese të palëve në zbatim të së drejtës ndërkombëtare detare dhe të kuadrit ligjor kombëtar të shtetit palë.

Në nenin 4 parashikohen masat që duhet të ndërmarrin shtetet palë për lehtësimin e transportit detar ndërmjet të dyja vendeve.

Në nenin 5 parashikohen dokumentet e nevojshme të anijes, dokumente të cilat janë të detyrueshme për t’u mbajtur në bordin e anijes, në zbatim të konventave ndërkombëtare të IMO-s në të cilat të dyja shtetet janë palë.

Në nenin 6, aktivitetet tregtare, parashikohet që në zbatim të legjislacionit vendas një palë ka të drejtë të vendosë përfaqësim në territorin e shtetit tjetër palë të marrëveshjes.

Në nenin 7, taksimi, parashikon që për të shmangur taksimin e dyfishtë taksat do të rregullohen me marrëveshje të palëve.

Nëpërmjet nenit 8 parashikohen incidentet detare me anën e të të cilave palët angazhohen që do t'u japin asistencë anijeve të palëve gjatë incidenteve në shtetet e tyre përkatëse, në zbatim të kuadrit ligjor ndërkombëtar dhe atij kombëtar.

Në nenin 9, dokumentet e udhëtimit të anëtarëve të ekuipazhit, palët njohin dokumentin e udhëtimit të ekuipazhit të anijeve të lëshuara nga administratat detare respektive.

Në neni 10 parashikohet që hyrja, kalimi tranzit dhe qëndrimi i ekuipazhit të bëhen pa viza, në zbatim të legjislacionit kombëtar të shtetit.

Neni 11, pajtueshmëria me dispozitat ligjore, parashikon legjislacionin në zbatim mbi anijen gjatë qëndrimit në portin e njërit shtet si edhe zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Detit, në të cilat parashikohet shprehimisht se juridiksioni ligjor që zbatohet brenda anijes është juridiksioni i flamurit dhe ndërhyrja e shtetit të portit bëhet vetëm pas kërkesës nga kapiteni i anijes ose lejes nga përfaqësuesit diplomatikë të shtetit.

Neni 12 parashikon që këshillimet të bëhen me kërkesë nga autoriteti kompetent i secilës prej palëve të marrëveshjes.

Neni 13 parashikon zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, ndërmjet palëve, nëpërmjet konsultimeve dhe bisedimeve.

Neni 14 parashikon që angazhimet e kësaj marrëveshjeje nuk cenojnë të drejtat dhe detyrimet e palëve nga marrëveshjet e tjera ndërkombëtare.

Neni 15 parashikon që ndryshimet e kësaj marrëveshjeje të bëhen me pëlqimin e ndërsjellë të palëve.

Neni 16, hyrja në fuqi, parashikon që kjo marrëveshje të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, me anë të të cilit palët njoftojnë njëra-tjetrën për përmbushjen e të gjitha procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje dhe do të jetë e vlefshme për 3 vjet, si dhe do të rinovohet automatikisht për një periudhë apo periudha të tjera të ngjashme, duke mbetur në fuqi derisa njëra nga palët kontraktuese të njoftojë palën tjetër me shkrim se kërkon të përfundojë këtë marrëveshje. Marrëveshja do të përfundojë pas 6 muajsh pas marrjes së këtij njoftimi në rrugë zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Institucioni përgjegjës për zbatimin e këtij projektligji është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është dërguar për mendim në Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë për Evropën dhe Punëve të Jashtme.

Këto institucione janë shprehur dakord për miratimin e këtij projektligji.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk sjell efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE